

GJYKATA E QARKUT NE MITROVICE

P.nr.25/10

1 Shtator 2010

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA E QARKUT TE MITROVICES- Trupi Gjykues i perbere nga Gjyqtarja e EULEX-it Agnieszka Klonowiecka-Milart si Kryetare e Trupit Gjykues dhe Charles Smith III dhe Christine Lindemann-Proetel si Anetare te Trupit Gjykues, me pjesemarrjen e Zyrtares Ligjore te EULEX-it Noora Aarnio si Procesmabajtese, ne lenden penale kunder

GEZIM BEGOLLI- pa pseudonim, i biri i Adem Begollit dhe Qefsere Brahimi, i lindur me 13 Dhjetor 1987 ne Mitrovice, Kosove, Shqiptar etnik i Kosoves, me banim ne fshatin Stan Terg, Komuna e Mitrovices, beqar, absolvent ne Fakultetin e Menagjimit dhe Teknologjise, menagjer i nje kompanie private, i gjendjes se mesme ekonomike, i pagjykuar me pare, ne arrest shtepiak nga data 07.11.2008 deri me 25.11.2008 dhe nen masen e sigurise qe te raportoje ne stacion te policise deri me daten 24.03.2009

ngarkohet sipas Aktakuzes PP.nr.115/08 te dates 23.03.2009 te ngritur nga Prokurorori dhe te vertetuar me Aktvendimin e Konfirmimit te dates 20 Maj 2010 per keto vepra penale

-**Tentim Vrasje**, sipas Nenit 146 ne lidheshmeri me Nenin 20 te Kodit Penal te Kosoves (KPK) dhe

-**Mbajtje ne Pronesi, Kontrolle, Posedim ose Perdorim i Pa-autorizuar i Armeve** nga Neni 328, paragrafi 2 i KPK.

TAHIR TAHIRI, pa pseudonim, djali i Nezir Tahirit dhe Safije Balaj, i lindur me 22 Shkurt 1984 ne Mitrovice, Kosove, me origjine Shqiptar etnik, me banim ne fshatin Trepce, Komuna e Mitrovices, beqar, ka kryer shkollen e mesme ekonomike, konduktor autobusi, i gjendjes se mesme ekonomike, i pagjykuar me pare

I ngarkuar sipas Aktakuzes PP.nr. 115/08 te dates 23 Mars 2009 te ngritur nga Prokurorori dhe te vertetuar me Aktvendimin e dates 20 Maj 2010, ne lenden penale **Lendim i Lehte Trupor** ne bashkekryerje me te miturin NN nen Nenin 153, paragarafin I, pika I te Kodit Penal te Kosoves (KPK).

NN

Ingarkuar sipas parashtreses per ndeshkim PPM.Nr. 02/09 te dates 23 Mars 2009, per vepren penale **Lendim i Lehte Trupor** ne bashkekryerje me Tahir Tahirin, nen Nenin 153, paragrafi 1, pika 1 te KPK

Pas mbajtjes se Gjykimit Kryesor te mbyllur pjeserisht per publikun me 1 Shataor 2010, ne prezencen e te akuzuarit Gezim Begolli, Tahir Tahirit dhe **NN** (gjithashtu edhe ne rolin e pales se demtuar), Avokateve Mbrojtes, Bashkim Mehana, Nexhat Beqiri dhe Rexhep Kacaniku, Pales se Demtuar Adnan Begolli dhe Prokurori Publik i EULEX-it Neeta Amin, pas keshillimit dhe votimit te mbajtur me 1 Shtator 2010 ka shpallur-ne te njejten dite-ne prezencen e te gjitheve, te akuzuarit Gezim Begolli, Avokatit te tij Mbrojtes Bashkim Mehana, Pales se Demtuar Adnan Begolli dhe Prokurorit Publik te Eulex-it, kete

AKTGJYKIM

I. Akuzuari Gezim Begolli

SHPALLET FAJTOR

Sepse me 7 Nentor 2008 ne Stan Terg, pa leje te autorizuar te leshuar nga autoritetet kompetente ka mbajtur nje pistolete te markes "Crvena Zastava" te kalibrit 7.62 mm me numrin serik C-208959 dhe kater fisheke te te njejtit kaliber.

Me kete i akuzuari **Gezim Begolli** ka kryer dhe eshte pergjegjes penal per vepren penale **Mbajtje ne Pronesi, Kontrolle, Posedim apo Perdorim te Pa-autorizuar te Armeve** nen Nenin 328, Paragrafin (2) te Kodit Penal te Kosoves (KPK)

II. Prandaj i Akuzuari Gezim Begolli denohet me dy vite burgim. Periudha e arrestit shtepiak nga 7 Nentori 2008 deri me 25 Nentor 2008 do te numerohet kundrejt ketij denimi.

III. Duke u bazuar ne Nenin 43 te KPK ekzekutimi i ketij denimi **suspendohet per periudhen verifikuese prej dy viteve.**

IV. Arma "Crvena Zastava" pistolete e kalibrit 7.62 mm, me numrin serik C208959 eshte konfiskuar nga Gezim Begolli sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328, Paragrafi (5) i KPK.

V. I akuzuari Gezim Begolli obligohet te paguaje shpenzimet e procedures penale perveq shpenzimeve per perkthyes dhe perkthime. Gjykata do te shpalle nje Aktvendim te veqante ne lidhje me shumen e shpenzimeve posa te furnizohet me te dhenat e tilla.

VI. **Akuza Tentim Vrasje kunder te akuzuarit Gezim Begolli** nuk pranohet pas terheqjes se akuzes nga ana e Prokurorit Publik.

VII. **Akuza Lendim i Lehte Trupor kunder te akuzuarit Tahir Tahiri** nuk pranohet pas terheqjes se akuzes nga ana e Prokurorit Publik.

VIII. **Parashtresa per ndeshkim per Lendim te Lehte Trupor kunder NN** nuk pranohet pas terheqjes se akuzes nga ana e Prokurorit Publik.

IX. Shpenzimet e procedures kunder Tahir Tahirit dhe NN do te mbulohen nga Shteti.

ARSYETIM

Me 15 Shkurt 2010, Kryetarja e Asamblese se Gjyqtareve te EULEX-it e ka perdorur te drejten e saj te caktoje Gjyqtaret e EULEX-it ne lendet qe bien nen kompetencen subsidiare te Gjyqtareve te EULEX-it sispas Nenit 3.3 "Ligjit mbi Kompetencat, Seleksionimin dhe Caktimin e Lendeve te Gjyqtareve te EULEX-it dhe Prokuroreve ne Kosove" dhe lenden numer P 25/10 (Gezim Begolli dhe Tahir Tahiri) e ka caktuar per Gjyqtaret e EULEX-it ne Gjykaten e Qarkut ne Mitrovice.

Me 2 Gusht 2010, Me 15 Shkurt 2010, Kryetarja e Asamblese se Gjyqtareve te EULEX-it e ka perdorur te drejten e saj te caktoje Gjyqtaret e EULEX-it ne lendet qe bien nen kompetencen subsidiare e Gjyqtareve te EULEX-it sispas Nenit 3.3 "Ligjit mbi Kompetencat, Seleksionimin dhe Caktimin e Lendeve te Gjyqtareve te EULEX-it dhe Prokuroreve ne Kosove" dhe lenden numer P 1/09 (NN) e ka caktuar per Gjyqtaret e EULEX-it ne Gjykaten e Qarkut ne Mitrovice.

I akuzuari Gezim Begolli eshte deklaruar fajtor per akuzen Mbajtje ne Pronesi, Kontrolle, Posedim ose Perdorim i Pa-autorizuar i Armeve nga Neni 328, paragrafi 2 i KPK.

Gjykata eshte e bindur se materiali i mbledhur ne dosjen e lendes e perkrahe ne menyre te mjaftueshme akuzen dhe deklarimin e dhene nga i akuzuari.

Ne deklaraten qe i pandehuri Gezim Begolli ia ka dhene policies me 7 Nentor 2008 ka sqaruar se pistoleta "Crvena Zastava" e kalibrit 7.62 mm, me numer serik C-208959 ka qene prone e gjyshit te tij dhe ajo ka qene e trasheguar nga ai pas vdekjes se gjyshit te tij ne vitin 1991. Mirepo, arma ka qene e rualjtur nen toke gjate shumices se kohes.

Dokumenti mbi konfiskimin e gjerave nr. 2009-BI -248 te dates 7 Nentor 2008 verteton faktin se pistoleta e tipit "Crvena Zastava" e kalibrit 7.62 mm me numer serik C-208959 dhe kater fisheke te te njejtit kaliber jane konfiskuar nga i pandehuri.

Denimi qe eshte aplikuar per Mbjajtje te Pa-autorizuar te Armeve nen Nenin 328 , paragrafi 2 i KPK shkon prej denimit me gjobe prej 7500 Euro e deri te denimi me burg prej nje deri ne tete vite. Nje varg i tille jo tradicional i sanksioneve te gatshme e lene Gjyaktin me nje diskrecion te gjere per vendosjen e lendeve individuale. Trupi Gjykues ne kete lende vendosi se dy vite burgim, te suspenduar per periudhen verifikuese prej dy viteve do ti sherbente me se mire qellimit te ndeshkimit nen Nenin 34 te KPK.

Trupi Gjykues ne kete lende ka konsideruar, si qeshtje te preventimit te pergjithshem, se frekuenca e krimeve te kryera me ane te perdorimit te armeve ne Kosove shpesh ka rezultuar ne vdekje apo lendim serioz dhe therret per sanksionimin per mbajtje ilegale te armeve me burgim me te gjate se minimal. Trupi Gjykues eshte i vendosur te dergoje sinjale se gjetja e lehte e armeve te zjarrit dhe perdorimit te tyre si mjet per zgjedhjen e problemeve nuk do te tolerohet pa u ndeshkuar.

Trupi Gjykues e ka marre si faktor rendues kohen e gjate te mbajtjes se armes pa leje te duhur gjate se ciles kohe i akuzuari e ka mbajtur ilegalisht armen dhe nuk ka tentuar ta legalizojte ate. Poashtu, Gjykata e mbane te akuzuarin pergjegjes se ai e ka mbajtur armen me vete ne vende publike duke e mbajtur ate te gatshme per ta perdorur. Nese nje sjellje e tille ka demonstruar qe te qendroje e pakualifikuar dhe e pandryshuar, dy vite burgim do te ishte proporcional me rrezikshmerine e krimit.

Trupi Gjykues e ka marre si faktor lehtesues ate se arma ka qene nje trashegim familjar dhe se eshte mbajtur, deri ne nje mase, jashte mendjes. Nuk ka kurrfare shenja te ndonje perdorimi te armes para ngjarjeve te perfshira ne akuza. Ne te vertete arma e hyre ne perdorim me 7 Nentor 2008 ka rezultuar nga nje incident i dhunshem e i pa-provokuar ku vellau i Gezim Begollit ka qene i sulmuar nga NN dhe Tahiri, dhe Gezim Begolli ka intervenuar. Si rezultat ka pasur viktime ne te dy anet.

Gjykata ka konkluduar se ka pasur rrethana qe paraqesin prognozimin pozitiv per te akuzuarit.

Pasojat e ngjarjes ku nje i ri eshte lenduar dhe procedura tjeter penale duhet te kete efekt sigurues ne te akuzuarin si dhe ne pjesemarresit tjere te ngjarjes.

Me tutje, konflikti qe ka shtire ne incidentin e dhunshem ka perfunduar deri ne kohen e gjykimit. Palet e te dy aneve ne menyre te vazhdueshme e kane siguruar gjykatën per zgjedhjen paqesore qe ka ndodhur ndermjet tyre dhe ata qe jane lenduar kane deklaruar se nuk deshirojne te vazhdojne me ndjekje penale dhe nuk deshirojne te paraqesin kerkesa civile. Prandaj gjykata ka konsideruar se qellimi restaurues i ndeshkimit eshte arritur.

I akuzuari nuk ka te regjistruar ndonje dosje te meparshme penale kunder tij . Duket nga dosja se ai ka lidhje te forta familjare dhe eshte i perkushtuar te zhvilloje biznesin dhe te shkollohet.

Prandaj opinioni i Gjykates ishte se nese te pandehurit i jipet masa e verifikimit, kjo do te ishte e mjaftuar per ta korrigjuar sjelljen e te akuzuarit dhe ta preventojte ate ne perseritjen e veprave penale.

Sipas Nenit 44 te KPK denimi i suspenduar mund ti shqiptohet kryesit te vepres penale, te denuar me burg deri ne dhjete vite nese aplikohen disipozitat lehtesuese te denimit.

Sipas Nenit 66 pika 2 e KPK, Gjykata mund te aplikojë lehtësimet kur gjykata konkludon se ka rrethana te veqanta lehtësuese te cilat tregojne se qellimi i ndeshkimit mund te arrihet duke shqiptuar nje denim me te lehte.

Perveq faktoreve lehtësues te diskutuar *supra*, Gjykata ka konsideruar se i akuzuari ka treguar pendim qe nga fillimi i hetuesise. Ai e ka pranuar fajesine e tij qe nga fillimi i procedures, vullnetarisht ia ka dorezuar armen oficerëve te policies dhe ka qene bashkepunues me zbatuesit e ligjit ne dhenjen e deshmise per armen dhe faktet tjera relevante per akuzat. Gjykat ka hetuar se sipas Ligjit mbi Plotesimin dhe Ndryshimin e Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves masa lehtësuese e denimit eshte parapare si nje pasoje e marreveshjes se deklarimit. Gjersa ne kete rast, teknikisht, nuk ka "marreveshje deklarimi" gjykata megjithate ka konsideruar se i akuzuari e ka ofruar menjehere deklarimin e fajesise se tij dhe ate e ka bere ne menyre te vazhdueshme. Masa lehtësuese e ndeshkimit ne kete rast do te ishte pra ne perputhje me praktiken aktuale penale te Kosoves, siq eshte reflektuar ne ligjin e lartepermendur.

Ndeshkimi tjetër i konfiskimit te armes eshte i detyrueshem me ligj sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Neni 328 Paragrafi (5) i KPK.

Te gjitha akuzat e mbetura jane terhequr nga Prokurori e qe ka rezultuar ne Aktvendimin e kesaj Gjykate mbi mos pranimin e akuzave duke u bazuar ne Nenin 398 te KPPK.

Gjykata e Qarkut ne Mitrovices

P nr. 25/10

E shkruar ne gjuhen Angleze, gjuhe e autorizuar.

Agnieszka Klonowiecka-Milart

Kryetare e Trupit Gjykses

Charles Smith III

Anetar i Trupit Gjykses

Noora Aarnio

Procesmbajtese

Christine Lindemann-Proetel

Anetare e Trupit Gjykses

Keshille Ligjore: Palet mund te paraqesin ankese me shkrim kunder ketij aktgjykimi ne Gjykatën Supreme permes Gjykates se Qarkut te Mitrovices, brenda pesembdhjete (15) diteve nga data e pranimi te ketij aktvendimi sipas Nenit 398 Paragrafi (1) te KPPK.

/s

eng/alb, 6 page

